



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.11

14 shkurt

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9679 datë 22.1.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për pjesëmarrjen në financimin e projektit të ndërtimit të portit të peshkimit, Durrës, Shqipëri”.....	159
Ligj nr.9680 datë 22.1.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për transportin ajror”.....	169
Ligj nr.9684 datë 6.2.2007	Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar	180
Vendim i Kuvendit nr.69, datë 6.2.2007	Për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	181
Dekret nr.5202 datë 7.2.2007	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	182

LIGJ
Nr. 9679, datë 22.1.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR
ZHVILLIM PËR PJESËMARRJEN NË FINANCIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË
PORTIT TË PESHKIMIT, DURRËS, SHQIPËRI”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim për pjesëmarrjen në financimin e projektit të ndërtimit të portit të peshkimit, Durrës, Shqipëri”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5200, datë 2.2.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

Projekti nr. ALB 020/Kredi
S:\Fagrts\Loan\Alb - 020(LN - Ord).rtf (06/02/2006 8:02M)

MARRËVESHJE KREDIE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
ISLAMIKE PËR ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË PORTIT
TË PESHKIMIT NË DURRËS, SHQIPËRI**

Kjo Marrëveshje nënshkruhet më ___/___/1425 H, e cila i përkon ___/___/2006 G, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu e tutje i quajtur “Huamarrës”) dhe Bankës Islamike për Zhvillim (këtu e tutje referuar si “Banka”).

Ndërsa:

A) Huamarrësi i ka kërkuar Bankës ta ndihmojë për mbulimin e kostos së financimit të Projektit të portit të peshkimit në Durrës (këtu e tutje të quajtur “Projekti”), sipas përshkrimit në tabelën – I të kësaj Marrëveshjeje duke i siguruar huanë e dhënë më poshtë;

B) Një nga qëllimet e Bankës është që t’i ndihmojë vendet e veta anëtare, duke livruar hua për financime të projekteve dhe programeve të rëndësishme;

C) Projekti konsiderohet të jetë teknikisht i bazuar, gjithashtu i përligjur nga pikëpamja ekonomike dhe shoqërore;

D) Banka ka rënë dakord, mbështetur edhe në sa më sipër, t’i japë Huamarrësit huanë bazuar në termat dhe kushtet e paraqitura më poshtë.

Për këto arsye, Palët janë marrë vesh për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Përkufizimet, kushtet e përgjithshme

Seksioni 1.01 Përkufizimet: Kudo ku janë përdorur në këtë Marrëveshje, përveç rasteve kur nga konteksti rezulton ndryshe, përkufizimet e dhëna në kushtet e përgjithshme kanë kuptimet e caktuara, që jepen si më poshtë vijon:

“Disbursim” nënkupton tërheqjen e shumës së huasë.

“Procedurë e disbursimit” nënkupton procedurën e disbursimit të Bankës.

“Data e vlefshme” nënkupton datën në të cilën Marrëveshja deklarohet e vlefshme nga Banka dhe i komunikohet si e tillë Huamarrësit nga Banka.

“Agjencia zbatuese” nënkupton Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) të Republikës së Shqipërisë, që është institucioni zbatues përgjegjës për zbatimin, realizimin dhe drejtimin, ose cilido institucion tjetër për të cilin bihet dakord nga Kredimarrësi dhe Banka.

“Kushte të përgjithshme” nënkuptojnë kushtet e përgjithshme të zbatueshme për hua dhe marrëveshje garancie të Bankës që i përkasin datës 8.11.1976.

“Dinari islamik/DI”, siç përkufizohet në nenin 4 (1) (a) të marrëveshjes themeluese të Bankës, është njësi për llogaritë e Bankës. Një DI është i barabartë me një të drejtë të veçantë të përfaqësimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

“Shuma e huasë” nënkupton shumën për të cilën Banka ka rënë dakord t’i japë Kredimarrësit në mënyrën e përcaktuar në seksionin 2.01 të kësaj Marrëveshjeje.

“Shuma fillestare” nënkupton shumën në total të kredisë, aktualisht e tërhequr nga Huamarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje.

“Udhëzime të prokurimit” nënkuptojnë udhëzimet për prokurim të mallrave dhe shërbimeve të financuara nga Banka.

“Projekti” dhe referime në “pjesë” të tij nënkupton Projektin dhe pjesë të tij, ashtu siç janë përshkruar në tabelën I të kësaj Marrëveshjeje.

“Tarifa e shërbimit” nënkupton tarifën që i paguhet Bankës nga Huamarrësi, ashtu siç përcaktohet në seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Kushte të përgjithshme: Palët në këtë Marrëveshje pranojnë të gjitha dispozitat e kushteve të përgjithshme si njëlloj të vlefshme dhe efektive, ashtu siç paraqiten në vijim.

Neni 2
Huaja

Seksioni 2.01 Shuma e kredisë. Banka bie dakord t’i japë Huamarrësit hua nga burimet e veta të zakonshme, në një shumë që nuk tejkalon barasvlerën e DI 6,13 - (gjashtë milionë e njëqind e tridhjetë mijë dinarë islamikë) vetëm sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Seksioni 2.02 Përveç rastit kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, kontratat për mallra dhe shërbime që do të financohen nga marrëveshja e huasë, do të prokurohen me anë të procedurave në përputhje me udhëzuesit e prokurimit të Bankës. Në këtë kontekst, Huamarrësi do t’i përmbahet rregullave të Organizatës së Konferencës Islamike lidhur me bojkotin ndaj shtetit të Izraelit.

Neni 3
Tërheqja dhe përdorimi i shumës së kredisë

Seksioni 3.01 Tërheqja. Shuma e kredisë do të tërhiqet nga Huamarrësi sipas tabelës - III dhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, kushteve të përgjithshme dhe procedurës së disbursimit, për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, për shpenzimet e bëra lidhur me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për projektin, për t’u financuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Data për kërkimin e disbursimit të parë. Nëse brenda 180 ditëve nga data e vlefshmërisë ose çdo date tjetër e mëvonshme, siç do të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, Huamarrësi nuk i paraqet Bankës një kërkesë për të bërë disbursimin e parë, Banka ka të drejtë ta pushojë këtë Marrëveshje në bazë të njoftimit përkatës drejtuar Huamarrësit.

Seksioni 3.03 Data e përfundimit të disbursimit. 31/12/2010 ose një datë e mëvonshme për të cilën do të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës, është data përfundimtare e tërheqjes nga shuma e huasë për qëllime të seksionit 6.03 (c) të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 3.04 Përdorimi i shumës së kredisë: Të gjitha shumat e tërhequra nga Huamarrësi do të përdoren vetëm për qëllime të projektit të financuar nga Banka.

Neni 4

Amortizimi, tarifa e shërbimit dhe vendet e pagesave

Seksioni 4.01 Amortizimi. Huamarrësi do të ripaguajë shumën fillestare në 25 (njëzet e pesë) vjet, duke përfshirë një periudhë shtyrjeje 7-vjeçare, e cila fillon nga data e kësaj Marrëveshjeje, në 36 (tridhjetë e gjashtë) këste të barabarta dhe të pandërprera gjashtëmujore siç parashikohet në tabelën - II (A) të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.02 Tarifa e shërbimit

a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një tarifë shërbimi në një shumë të vlerësuar fillimisht në DI 558,700.46 (pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind, pikë dyzet e gjashtë dinarë islamikë), sipas mënyrës së përcaktuar në tabelën II (B) të kësaj Marrëveshjeje.

b) Nga Palët në këtë Marrëveshje bihet dakord dhe kuptohet se shuma fillestare e tarifës së shërbimit, e referuar në nënseksionin 4.02 (a), është veçse një vlerësim i bazuar në prezumimin e periudhës së zbatimit dhe të periudhës së disbursimit të shumës së plotë të kredisë siç është parashikuar këtu. Gjithashtu bihet dakord se shuma reale e tarifës së shërbimit do të përlllogaritet pas zbatimit të Projektit, duke marrë në konsideratë faktin që kjo shumë nuk do të tejkalojë 2.5% (dy pikë pesë për qind) të shumës vjetore të kredisë.

c) Tarifa e shërbimit do të akumulohet nga data e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.03 Vendet e pagesave. Çdo pagesë, duke përfshirë këtu edhe rikthimin e shumës themelore, do të konsiderohet e shlyer kur fondet përkatëse të këtyre pagesave të jenë kredituar në një llogari të përcaktuar për këtë qëllim nga Banka.

Seksioni 4.04 Pa cenuar tërësinë e dispozitave të seksionit 3.03 të mësipërm, çdo pagesë e mëtejshme do të gjykohet të jetë kryer në mënyrë të rregullt, kur një prej bankave të mëposhtme i konfirmon Bankës për arkëtimin prej saj të kësaj pagese në llogarinë e Bankës:

a) Nëse kjo pagesë është bërë në dollarë amerikanë:

Llogaria nr. IBAN GB36SINT 609 28000 159111

Gulf International Bank (UK) Limited

One Knightsbridge, London SW1X 7XS

United Kingdom/Britania e Madhe

SWIFT CODE: SINTGB2L

b) Nëse kjo pagesë është bërë në paund britanikë:

Llogaria nr. 122432 GBP2520 01

Gulf International Bank B.S.C.

London Branch, One Knightsbridge

London SW1X 7XS

United Kingdom/Britania e Madhe

Teleks Nr. 8812889/8813326 GIBANK G

SWIFT CODE: GULFGB2L

c) Nëse kjo pagesë është bërë në monedhën euro:

Llogaria nr. IBAN FR76 4389 9000 0196 9650 0151 088

(Union de Banques Arabes et Francaises (UBAF)/

Bashkimi i Bankave Arabe dhe Franceze (BBAF)

92523 Paris, Neuilly Cedex, Francë
Teleks Nr. 610334 UBAF
SWIFT CODE: UBAFRPPXXX

Neni 5 **Zbatimi i Projektit**

Seksioni 5.01 Huamarrësi merr përsipër:

a) të zbatojë projektin dhe të drejtojë punimet e tij, përmes agjencisë së zbatimit, me përkushtim dhe efektivitet në përputhje me të gjitha praktikat e domosdoshme administrative, financiare, inxhinierike dhe ekonomike, nën mbikëqytjen e personelit dhe drejtuesve të kualifikuar dhe me përvojë, si dhe në përputhje me planin e investimit, buxhetit, planifikimet dhe specififikimet lidhur me Projektin që i është dorëzuar Bankës dhe që është miratuar prej saj;

b) të paraqesë, në mënyrë të detajuar, sipas kërkesave të Bankës, me qëllim miratimi nga ana e saj, të çdo ndryshimi të dukshëm që ndodh në buxhetin, planet dhe specififikimet e Projektit, si dhe çdo ndryshim thelbësor në secilën prej kontratave për shërbime ose prokurim mallrash që kanë të bëjnë me zbatimin e Projektit.

Seksioni 5.02 Pa ndonjë kufizim ose pengesë mbi detyrimet e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do t'i lejojë Bankës një periudhë kohe të arsyeshme për të dhënë mendimet e veta mbi çdo ndryshim thelbësor ose çdo shtesë të periudhës së rënë dakord në secilën nga kontratat për shërbime ose prokurime mallrash, lidhur me zbatimin e Projektit.

Neni 6 **Parakushte shtesë përpara disbursimit nga ana e Bankës**

Huamarrësi, para se të dorëzojë kërkesën e parë për tërheqjen e fondit, do të paraqesë procedurën që propozon të ndiqet ose që do të ndikojë me qëllim që të vazhdojë procedura për prokurim konkurrues në zbatim të seksionit 2.02 dhe 7.02 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe do të marrë miratimin e Bankës përsa më sipër.

Neni 7 **Dispozita të veçanta**

Seksioni 7.01 Huamarrësi do të vërë në dispozicion, sapo t'i kërkohet, të gjitha shumat që përfshijnë sasinë e nevojshme për kostot në monedhë vendase dhe kosto shtesë që do të nevojiten për vijueshmërinë e Projektit, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën.

Seksioni 7.02 Përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, Huamarrësi do të trajtojë të gjitha kontratat që financohen nga vazhdimësia e kësaj huaje për zbatimin e Projektit përmes procedurave të tenderit të hapur ndërkombëtar dhe do të kërkojë miratim paraprak nga Banka për shpalljen fituese të çdo kontrate, vlera e së cilës tejkalon shumën ekuivalente prej njëqind e pesëdhjetë mijë dinarë islamikë (DI 150,000).

Seksioni 7.03 Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës, menjëherë pas miratimit prej tij, studimet dhe planet specifike të Projektit, afatet e zbatimit të tij dhe çdo ndryshim thelbësor që u bëhet atyre, në një mënyrë të detajuar, sipas kërkesave të herëpashershme nga ana e Bankës.

Seksioni 7.04 Huamarrësi do të çelë dhe do të mbajë regjistra të përshtatshëm për të identifikuar mallrat e financuara nga vijueshmëria e huasë, me qëllim që të bëjë publik përdorimin e tyre në projekt, të dokumentojë ecurinë e Projektit dhe të pasqyrojë në përputhje me praktikat e konsoliduara të kontabilitetit veprimet dhe pozitën financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.05 Huamarrësi do të përballojë të gjitha rastet e arsyetuara për vizita nga përfaqësuesit e akredituar të Bankës me qëllime të lidhura me huanë, si dhe për të kontrolluar Projektin, mallrat dhe çdo dokument dhe regjistër tjetër përkatës, si dhe do t'i paraqesë Bankës të gjitha informacionet sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës, lidhur me shpenzimet sipas ecurisë së huasë, projektit, mallrave dhe veprimeve, si dhe të pozitës financiare të institucionit zbatues.

Seksioni 7.06 Me qëllim kryerjen dhe zbatimin e projektit, Huamarrësi angazhohet të marrë të gjitha masat e duhura në mënyrë që institucioni zbatues të funksionojë gjatë gjithë kohës, në përputhje me rregullat dhe udhëzimet, si në formë, ashtu edhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, si dhe të ketë aftësi administrative dhe drejtuese të përshtatshme për ecurinë e nevojshme dhe efikase të veprimtarisë së Projektit.

Seksioni 7.07 Huamarrësi do të sigurojë ose ndikojë për pajisjen me sigurime të besueshme të gjitha mallrat e financuara nga zbatimi i huasë. Këto sigurime do të mbulojnë transportin detar, transit dhe rreziqe të tjera rastësore për blerjen dhe importimin e mallrave në territorin e Huamarrësit dhe dërgimin e tyre në vendin e zbatimit të projektit dhe do të sigurohen në shuma që janë në përputhje me praktikat tregtare të qëndrueshme. Këto sigurime do të bëhen në përputhje me legjislacionin e Huamarrësit sipas marrëveshjes se mallrat do të risigurohen në një shoqëri që do të paguajë shumat e sigurimit në monedhë lehtësisht të shkëmbyeshme.

Seksioni 7.08 Huamarrësi do të veprojë në atë masë që gjykohet si e arsyeshme për të disponuar truallin e nevojshëm dhe të drejtat e lidhura me të, siç kërkohet për realizimin e Projektit dhe do t'i paraqesë Bankës, me kërkesën e kësaj të fundit, prova të mjaftueshme se trualli dhe të drejtat e lidhura me të janë vënë në shërbim të realizimit të projektit.

Seksioni 7.09 Huamarrësi do të ndërmarrë veprime nga ana e vet kur të jetë e nevojshme për të lejuar institucionin zbatues të realizojë projektin dhe nuk do të ndërmarrë ose lejojë të ndërmerret ndonjë veprim që mund të ndalojë ose ndërhyjë në zbatimin, ose veprimtarinë e projektit, ose në përmbushjen e çdonjërit prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.10 Të gjitha dokumentet e Bankës, regjistrat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen nga Banka dhe nga Huamarrësi si çështje konfidenciale.

Neni 8 **Raportet**

Seksioni 8.01

a) Huamarrësi dhe Banka do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar se do të përmbushin objektivat e huasë. Për këtë qëllim, secili prej tyre do t'i dorëzojë tjetrit informacionin e duhur sipas kërkesës së arsyetuar, lidhur me gjendjen e përgjithshme të huasë. Nga ana e Huamarrësit, ky informacion do të përfshijë të dhëna lidhur me kushtet ekonomike dhe financiare në shtetin e Huamarrësit dhe gjendjen e bilancit të pagesave të Huamarrësit.

b) Huamarrësi dhe Banka, në mënyrë të herëpashershme dhe mbi bazë të kërkesës së secilës Palë, do të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre, përmes përfaqësuesve përkatës, për sa i takon çështjeve që kanë të bëjnë me qëllimet e huasë, mbështetjen me shërbimet përkatëse dhe përmbushjen e detyrimeve nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 8.02

a) Huamarrësi angazhohet të kryejë dorëzimin ose të ndikojë për dorëzimin, në Bankë, të secilit prej raporteve të mëposhtme, duke përmbushur tërësisht kërkesat e kësaj të fundit dhe në kohën e përcaktuar:

i) brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbarimi i secilit tremujor ose brenda ndonjë periudhe tjetër që Palët mund të bien dakord, raporte për zbatimin e projektit në atë mënyrë që Banka do të kërkojë herë pas here;

ii) raporte të tjera që Banka, në mënyrë të arsyetuar, do të kërkojë lidhur me investimin e shumës së huasë të disbursuar dhe ecurinë e Projektit;

iii) menjëherë pas përfundimit të Projektit, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas datës përfundimtare ose një date të mëvonshme, siç mund të bihet dakord për këtë qëllim nga Huamarrësi dhe Banka, Huamarrësi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Bankës një raport të plotë me qëllimet dhe detajet përkatëse, sipas kërkesës së arsyetuar të Bankës, lidhur me zbatimin dhe veprimet fillestare të Projektit.

b) Dokumentet e përshkruara në këtë seksion do të noterizohen sipas vullnetit të lirë të Bankës, në atë mënyrë që Banka do ta gjykojë të arsyeshme.

Neni 9
Vlefshmëria

Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi deri sa:

A) (1) Bankës t'i jepen evidenca të kënaqshme lidhur me zbatimin dhe ndjekjen e kësaj Marrëveshjeje prej Huamarrësit sipas autorizimit përkatës ose ratifikimit nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;

2) opinioni ligjor që rrjedh nga autoriteti ligjor i Republikës së Shqipërisë, që deklaron se:

i) lidhja e marrëveshjes nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Bankës është në pajtim me Kushtetutën dhe të gjitha ligjet e tjera përkatëse në fuqi në Republikën e Shqipërisë; dhe

ii) termat dhe kushtet e marrëveshjes përbëjnë detyrime të zbatueshme detyruese mbi Republikën e Shqipërisë, të jetë i pranueshëm për Bankën.

B) Një letër autorizimi do të lëshohet nga Ministria e Financave ose ndonjë institucion tjetër i autorizuar për këtë qëllim nga ana e Huamarrësit për Bankën qendrore, ose subjektin që ushtron funksionet e një banke qendrore, se pagesa nga Huamarrësi në përputhje me këtë Marrëveshje të shumës themelore dhe këstet e tarifës së shërbimit do të bëhen nga banka qendrore ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, në datat e përcaktuara.

C) një vërtetim nga Banka Qendrore ose subjekti që ushtron funksionet e një banke qendrore, i cili demonstroi se është marrë letra e autorizimit dhe se do t'i bashkëlidhet udhëzimeve të përfshira në të do t'i dërgohet Bankës nga Huamarrësi.

Neni 10
Përfundimi i marrëveshjes për moszbatueshmëri

Nëse Marrëveshja nuk hyn në fuqi para datës 22.1.2007, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e palëve të përfshira këtu do të shuhen, përveç se kur Banka pas marrjes në konsideratë të të gjitha shkaqeve të vonësës, do të përcaktojë një datë të mëvonshme për qëllime të këtij neni. Banka menjëherë do të njoftojë Huamarrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 11
Dispozita të ndryshme

Seksioni 11.01 Përfaqësuesit e autorizuar. Ministri i Financave i Huamarrësit dhe çdo person ose persona që ai do të caktojë me shkrim do të konsiderohen si përfaqësuesit e autorizuar të Huamarrësit për qëllime të seksionit 10.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 11.02 Data e Marrëveshjes. Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data e Marrëveshjes do të jetë ajo që shfaqet në pjesën hyrëse të saj.

Seksioni 11.03 Adresa. Adresat e mëposhtme janë dhënë për qëllime të seksionit 10.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.1

Tiranë, Shqipëri.

Telefon: ++355 4 228 405

Fax.: ++355 4 228 494

Për Bankën Islamike për Zhvillim:

P.O. Box: 5925

Jeddah 21432, Mbretëria e Arabisë Saudite

Teleks: 601137 ISDB SJ

Kabëll: BANKISLAMI JEDDAH

Telefaks: 6366871 JEDDAH

Për sa më sipër, Banka dhe Kredimarrësi, secili duke vepruar me anë të përfaqësuesve të vet të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze në datën dhe vitin e paraqitur më sipër.

TABELA I PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Fusha e veprimit të Projektit përfshin aktivitetet e mëposhtme:

A. Ndërtimi i mjediseve të portit

A1- Masat paraprake dhe rruga hyrëse: Ky nënkomponent ka të bëjë me kostot e mobilizimit dhe çmobilizimit dhe ndërtimin e rrugës hyrëse 600 metra të gjatë dhe 6.0 metra të gjerë për në portin e peshkimit.

A2- Bonifikimi i tokës (0.8 hektarë): një zonë rreth 0.8 hektarë do të bonifikohet në qendër të pengesës dallgëpritëse kryesore.

A3- Pengesa dallgëpritëse kryesore (600 m): Pengesa dallgëpritëse kryesore do të jetë me bazë gurësh të palatuar, me gjatësi totale prej 600 metrash.

A4- Pengesa dallgëpritëse e bregut të mbrojtur nga era (96 metra): Gjatësia e pengesës dallgëpritëse të bregut të mbrojtur nga era nga vija e pengesës dallgëpritëse ekzistuese do të jetë 96 metra.

A5- Bankina e bregut (175 metra): duke përkrahur gjatësinë e basenit në 175 metra, bankina e bregut do të formojë bazën e pengesave dallgëpritëse.

A6- Pengesat dallgëpritëse: tre pengesa dallgëpritëse do të ndërtohen për zonën e bllokuar. Një pengesë dallgëpritëse do të jetë e ngurtë dhe dylundruese. Çdo pengesë dallgëpritëse do të jetë afërsisht 81 metra e gjatë dhe 4.7 metra e gjerë.

A7- Ndërtesat e portit dhe parcelat tregtare: Ndërtesat e portit të peshkimit do të përmbajnë:

- Ndërtesën FMO, 500 m² mbi dy kate;

- Bllokun e higjienës, 35 m² dhe nënstacionin, 9 m²;

- Vendrojnë, 3 m² dhe mjedisin e shitjes së karburantit, 1.8 m² (kabina modulare).

Porti do të pajiset me zona shërbimesh (ujë i pijshëm, ujërat e zeza, energjia dhe shërbimet telefonike) për tre godina tregtare që do të krijohen në mënyrë të pavarur nga palët e treta të përfshira në eksportin e prodhimeve të peshkut dhe peshkimit. Çdo zonë do të jetë 15 m x 16.5 m, por asnjë konstruksion godine nuk është parashikuar nga projekti.

A8 - Shërbime komunale

i) Furnizimi me ujë të pijshëm;

ii) Mjediset e ujërave të zeza;

iii) Furnizimi me karburant;

iv) Furnizimi me energji elektrike;

v) Telefon, komunikimet VHF detare dhe shërbime të tjera.

B. Shërbime konsulence

Komponenti përbëhet prej përzgjedhjes së një firme konsulente: i) për të përgatitur projektimin e detajuar inxhinierik, (ii) për të përgatitur dokumentet e ofertimit, (iii) për të asistuar agjencinë ekzekutuese në procesin e prokurimit dhe (iv) për të mbikëqyrur punimet gjatë fazës së ndërtimit.

C. Njësia e menaxhimit të Projektit (NJMP)

Një njësi e menaxhimit të Projektit do të krijohet në Tiranë, nën varësinë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Është propozuar që NJMP - ja do të pajiset me personel me kohë të plotë si më poshtë: (i) Drejtori i NJMP, (ii) inxhinieri civil, (iii) specialisti i prokurimit, (iv) oficeri i disbursimit/menaxhimit financiar dhe (v) shoferi.

Projekti do të mbajë stafin kryesor të PMU-së ekzistuese të Bankës Botërore për Projektin Pilot të Zhvillimit të Peshkimit.

Projekti do të financojë pagat për anëtarët e stafit të NJMP-së, si dhe kostot e tij operacionale dhe përvetësimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe një automjet.

Gjithashtu, do të organizohet një vizitë familjarizuese në Bankën e Zhvillimit Islamik për anëtarët e stafit të NJMP - së dhe një seminar njohës.

D. Auditimi financiar

Një firmë e kualifikuar, e pavarur auditimi, do të përzgjidhet me qëllim që të auditojë deklaratat financiare të projektit.

**TABELA II (A)
RIPAGESAT E SHUMËS THEMELORE**

Shteti: Republika e Shqipërisë

Projekti: Porti i peshkimit në Durrës

Shuma e huasë: DI 6,13 milionë

Periudha e huasë: 25 vjet.

Periudha e shtyrjes: 7 vjet.

Tarifa e shërbimit: DI 558,700.46.

Numër	Datë	Shuma themelore (Principali) (DI)
1	31.12.2013	170,277.78
2	30.06.2014	170,277.78
3	31.12.2014	170,277.78
4	30.06.2015	170,277.78
5	31.12.2015	170,277.78
6	30.06.2016	170,277.78
7	31.12.2016	170,277.78
8	30.06.2017	170,277.78
9	31.12.2017	170,277.78
10	30.06.2018	170,277.78
11	31.12.2018	170,277.78
12	30.06.2019	170,277.78
13	31.12.2019	170,277.78
14	30.06.2020	170,277.78
15	31.12.2020	170,277.78
16	30.06.2021	170,277.78
17	31.12.2021	170,277.78
18	30.06.2022	170,277.78
19	31.12.2022	170,277.78
20	30.06.2023	170,277.78
21	31.12.2023	170,277.78
22	30.06.2024	170,277.78
23	31.12.2024	170,277.78
24	30.06.2025	170,277.78
25	31.12.2025	170,277.78
26	30.06.2026	170,277.78
27	31.12.2026	170,277.78
28	30.06.2027	170,277.78
29	31.12.2027	170,277.78
30	30.06.2028	170,277.78

31	31.12.2028	170,277.78
32	30.06.2029	170,277.78
33	31.12. 2029	170,277.78
34	30.06. 2030	170,277.78
35	31.12. 2030	170,277.78
36	30.06. 2031	170,277.78
Totali:		6,130,000.00

TABELA II (B)
PAGESA E TARIFËS SË SHËRBIMIT

Shteti: Republika e Shqipërisë
 Projekti: Porti i peshkimit në Durrës
 Shuma e huasë: DI 6,13 milionë
 Periudha e huasë: 25 vjet.
 Periudha e shtyrjes: 7 vjet.
 Tarifa e shërbimit: DI 558,700.46

Numër	Datë	Shuma Themelore (Principali) (DI)
1	31.12.2006	11,174.01
2	30.06.2007	11,174.01
3	31.12.2007	31,925.74
4	30.06.2008	31,925.75
5	31.12.2008	31,925.76
6	30.06.2009	31,925.77
7	31.12.2009	31,925.78
8	30.06.2010	31,925.79
9	31.12.2010	31,925.80
10	30.06.2011	31,287.23
11	31.12.2011	31,287.23
12	30.06.2012	31,287.23
13	31.12.2012	31,287.23
14	30.06.2013	31,287.23
15	31.12.2013	31,287.23
16	30.06.2014	31,287.23
17	31.12.2014	31,287.23
18	30.06.2015	31,287.23
19	31.12.2015	31,287.23
Totali:		558,700.46

TABELA III
TËRHEQJA E TË ARDHURAVE TË HUASË

Shuma e të ardhurave të huasë së Bankës Islamike për Zhvillim prej DI 6,13 milionë (afërsisht e barazvlefshme me 8.77 milionë dollarë amerikanë) do të tërhiqet për të mbuluar kostot e zërave si më poshtë:

Komponenti	BIZH			Qeveria		Totali %	BIZH
	L.C	F.C	Totali	L.C	Totali		
A- Ndërtimi i mjediseve të portit	2.00	4.75	6.75	1.10	1.10	7.85	86%
B- Shërbimet e konsulencës	0.20	0.31	0.51	-	-	-	100%
C- Njësia e menaxhimit të Projektit (NJMP)	0.27	0.05	0.32	0.02	0.02	0.34	94%
D- Kontrolli financiar	0.05	0.00	0.05	-	-	-	100%
Kostoja bazë	2.52	5.11	7.63	1.12	1.12	8.75	87%
Kontingjencat fizike (10 %)	0.25	0.51	0.76	0.11	0.11	0.87	
Kontingjencat e çmimit (5 %)	0.13	0.25	0.38	0.05	0.05	0.43	
Totali	2.90	5.87	8.77	1.28	1.28	10.05	87%

LIGJ
Nr. 9680, datë 22.1.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS PËR TRANSPORTIN AJROR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për transportin ajror”.

Neni 2

Ligji nr.9067, datë 15.5.2003 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për transportin ajror””, shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5201, datë 2.2.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

MBI TRANSPORTIN AJROR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Belgjikës:
duke qenë Palë të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, të hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1994;
me dëshirën për të përfunduar një marrëveshje plotësuese të Konventës në fjalë, për të vendosur shërbime ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre përkatëse;
me dëshirën për të siguruar nivelin më të lartë të sigurisë dhe sigurimit në transportin ajror ndërkombëtar,
ranë dakord si vijon:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Konvente, përveç rasteve kur konteksti e parashikon ndryshe:

a) Termi “Konventë” nënkupton Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar të hapur për nënshkrim në Çikago më 7 dhjetor 1994 dhe përfshin çdo aneks të miratuar sipas nenit 90 të kësaj Konvente dhe çdo ndryshim të anekseve ose të Konventës sipas nenit 90 dhe 94 të saj, për sa kohë që këto anekse dhe ndryshime janë miratuar apo ratifikuar nga të dyja Palët Kontraktuese.

b) Termi “Marrëveshje” nënkupton këtë Marrëveshje, aneksin bashkëngjitur saj dhe çdo modifikim të Marrëveshjes apo të aneksit.

c) Termi “autoritete aeronautike” nënkupton: në rastin e Mbretërisë së Belgjikës, Shërbimi Publik Federal i Transportit dhe i Lëvizjes dhe në rastin e Republikës së Shqipërisë, Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, në cilësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil, ose në të dyja rastet, çdo autoritet apo person tjetër i autorizuar për të kryer funksionet që ushtrohen tani nga autoritetet e lartpërmendura.

d) Termat “territor”, “shërbim ajror”, “shërbim ajror ndërkombëtar”, “linjë ajrore” dhe “ndalesë jo për qëllime trafiku” kanë përkatësisht kuptimin që përcaktohet në nenin 2 dhe 96 të Konventës.

e) Termi “linja ajrore e caktuar” nënkupton një linjë ajrore që është caktuar dhe autorizuar në përputhje me nenin 3 dhe 4 të kësaj Marrëveshjeje.

f) Termi “shërbimet e miratuara” nënkupton shërbimet ajrore të caktuara në drejtimet e specifikuara në aneksin e kësaj Marrëveshjeje për transportin e pasagjerëve, ngarkesës apo postën, veçan ose të kombinuara.

g) Termi “tarifë” nënkupton çmimet që duhen paguar për transportin e pasagjerëve, bagazheve dhe ngarkesës dhe kushtet sipas të cilave zbatohen këto çmime, përfshirë këtu çmimet dhe kushtet për agjencinë dhe shërbime të tjera ndihmëse, por duke përjashtuar shpërblimin dhe transportin e postës.

h) Termi “ndryshimi i kursit të drejtimit” nënkupton kryerjen e një prej shërbimeve të miratuara nga një linjë ajrore e caktuar, në mënyrë të tillë që një pjesë e rrugës të bëhet nga një mjet fluturimi i ndryshëm në kapacitet nga ai që bën pjesën tjetër të rrugës.

i) Termat “pajisje e mjetit të fluturimit”, “pajisje tokësore”, “pjesë këmbimi” kanë respektivisht kuptimet që përcaktohen në aneksin 9 të Konventës.

Neni 2

Dhënia e të drejtave

1. Çdo Palë Kontraktuese i jep Palës tjetër Kontraktuese të drejtat e mëposhtme për kryerjen e shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga linjat e caktuara ajrore:

- a) të fluturojë pa u ulur në territorin e saj;
- b) të bëjë ndalesa në territorin e saj, por jo për qëllime trafiku;
- c) të bëjë ndalesa në territorin e saj për ngarkim dhe shkarkim, ndërsa fluturon në rrugët e specifikuar në aneks, për trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve, ngarkesës dhe postës me origjinë nga, apo drejtuar për në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Asnjë dispozitë në paragrafin 1 të këtij neni nuk konsiderohet se i delegon linjës ajrore të caktuar privilegjin për të marrë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese pasagjerët, ngarkesën dhe postën e transportuar për shpërblim apo huazim dhe të destinuar për një pikë tjetër në territorin e asaj Pale Kontraktuese.

Neni 3

Caktimi i kryerjes së shërbimeve

1. Çdo Palë Kontraktuese ka të drejtë të caktojë për Palën tjetër Kontraktuese, me notë diplomatike, një ose më shumë linja ajrore për të kryer shërbimet e miratuara në drejtimet e specifikuar në aneks për këtë Palë Kontraktuese.

2. Çdo Palë Kontraktuese ka të drejtë të tërheqë nga Pala tjetër Kontraktuese, me notë diplomatike, caktimin e një linje ajrore dhe të caktojë një tjetër.

Neni 4

Autorizimi për kryerjen e shërbimeve

1. Pas marrjes së njoftimit për caktimin e një linje ajrore nga një Palë Kontraktuese sipas nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e saj, u japin pa vonesë linjave ajrore të caktuara autorizimin e duhur për kryerjen e shërbimeve të miratuara, për të cilat këto linja ajrore janë caktuar.

2. Pas marrjes së këtyre autorizimeve, linjat ajrore mund të fillojnë në çdo kohë të kryejnë shërbimet e miratuara, tërësisht apo pjesërisht, me kusht që linjat ajrore të veprojnë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe që tarifat të vendosen në përputhje me dispozitat e nenit 13 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Anulimi ose pezullimi i autorizimit për veprim

1. Autoritetet aeronautike të çdo Pale Kontraktuese kanë të drejtë të mos japin autorizimet e përmendura në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me linjat ajrore të caktuara nga Pala Kontraktuese, të anulojnë ose të pezullojnë këtë autorizim ose të vendosin kushte, të përkohshme ose të përhershme:

a) nëse këto linja ajrore nuk arrijnë t'i bindin që janë të kualifikuara për të përmbushur kushtet e parashtruara në ligje dhe rregullore të zbatuara normalisht dhe logjikisht në kryerjen e shërbimeve ajrore ndërkombëtare nga këto autoritete në përputhje me Konventën;

b) nëse këto linja ajrore nuk arrijnë të veprojnë në përputhje me kushtet e parashtruara në këtë Marrëveshjeje;

c) nëse këto linja ajrore nuk arrijnë të veprojnë sipas ligjeve dhe rregulloreve të asaj Pale Kontraktuese;

d) 1) në rastin e një linje ajrore të caktuar nga Mbretëria e Belgjikës:

i) nëse linja ajrore nuk vendoset në territorin e Mbretërisë së Belgjikës sipas Traktatit Themelues të Komunitetit Europian ose nuk ka një licencë të vlefshme për të vepruar në përputhje me të drejtën e Komunitetit Europian; ose

ii) kontrolli efikas rregullator i linjës ajrore nuk ushtrohet ose nuk mbahet nga Shteti Anëtar përgjegjës për të lëshuar Certifikatën e Operatorëve Ajrorë, ose autoriteti përkatës aeronautik nuk identifikohet qartë në caktimin e linjës ajrore; ose

iii) linja ajrore nuk është në pronësi, drejtpërsëdrejti ose në pronësi të shumicës, ose nëse nuk kontrollohet në mënyrë efektive nga Shtetet Anëtare të Komunitetit Europian ose Shoqata Europiane e Tregtisë së Lirë dhe/ose nga shtetasit e këtyre shteteve;

2) në rastin e një linje ajrore të caktuar nga Republika e Shqipërisë:

i) nëse linja ajrore nuk përfshihet dhe nuk e ka qendrën e saj kryesore të biznesit në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nëse nuk ka Certifikatën e Operatorit Ajror të lëshuar nga autoritetet aeronautike të Republikës së Shqipërisë.

2. Nëse një masë e menjëhershme nuk është thelbësore për të parandaluar shkeljen e ligjeve dhe rregulloreve të përmendura më lart, të drejtat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni ushtrohen vetëm pas konsultimeve me autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve

1. Ligjet dhe rregulloret e një Pale Kontraktuese në lidhje me pranimin, qëndrimin ose nisjen nga territori i saj i mjeteve të fluturimit të përfshirë në lundrimin ndërkombëtar ajror ose në lidhje me komandimin dhe lundrimin e këtij mjeti fluturimi respektohen nga linja ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese me hyrjen, daljen dhe qëndrimin e tyre brenda territorit në fjalë.

2. Ligjet dhe rregulloret e një Pale Kontraktuese në lidhje me hyrjen, zhdoganimin, kalimin transit, emigrimin, pasaportat, doganat, valutën, kërkesat sanitare dhe karantinën respektohen nga linjat ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese dhe nga ose në emër të ekuipazhit, pasagjerëve, ngarkesës dhe postës së tyre gjatë kalimit transit, pranimit, nisjes dhe qëndrimit brenda territorit të kësaj Pale Kontraktuese.

Pasagjerët gjatë kalimit transit përmes territorit të njëjës Palë Kontraktuese i nënshtrohen vetëm një kontrolli të thjeshtë.

Kjo dispozitë nuk zbatohet nëse pasagjeri kalon transit për në një destinacion që ndodhet në një shtet, Palë e Konventës në përputhje me Marrëveshjen Shengen të 14 qershorit 1985.

3. Asnjë nga Palët Kontraktuese nuk i jep avantazhe linjës ajrore të saj apo të linje tjetër ajrore më shumë sesa një linje ajrore të përfshirë në shërbime të ngjashme ajrore ndërkombëtare të caktuar nga Pala tjetër Kontraktuese në zbatim të rregulloreve të specifikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni ose në përdorim të aeroporteve, rrugëve ajrore, shërbimeve të trafikut ajror dhe ambienteve të tjera nën kontrollin e saj.

Neni 7

Certifikatat, licencat dhe siguria

1. Certifikatat e sigurisë së fluturimit, certifikatat e kompetencës dhe licencat e lëshuara ose të bëra të vlefshme nga një Palë Kontraktuese dhe akoma në fuqi, njihen si të vlefshme nga Pala tjetër Kontraktuese për qëllimin e kryerjes së shërbimeve të miratuara në drejtimet e specifikuara në aneks, me kusht që këto certifikata ose licenca të jenë lëshuar apo bërë të vlefshme në përputhje me standardet e vendosura në këtë Konventë.

Megjithatë, çdo Palë Kontraktuese, për qëllime të fluturimeve mbi territorin e tyre, gëzon të drejtën të refuzojë njohjen e certifikatave të kompetencës dhe licencave të dhëna për shtetasit e saj nga Pala tjetër Kontraktuese.

2. Nëse certifikatat ose licencat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni do të jepeshin ose do të bëheshin të vlefshme sipas kërkesave të ndryshme nga standardet e caktuara në Konventë dhe nëse ky dallim i është paraqitur Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese mund të kërkojnë konsultime në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje, me synim për t'u bindur që kërkesat në fjalë janë të pranueshme për ta.

Mosarritja e një marrëveshjeje të pranueshme në çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e fluturimit, përbën arsye për zbatimin e nenit 5 të Marrëveshjes.

3.1 Çdo Palë Kontraktuese mund të kërkojë konsultime në çdo kohë në lidhje me standardet e sigurisë në çdo zonë në lidhje me ekuipazhin e avionit, mjetin e fluturimit ose komandimin e tyre të miratuar nga Pala tjetër Kontraktuese. Këto konsultime bëhen brenda 30 ditësh nga kjo kërkesë.

3.2 Nëse pas këtyre konsultimeve një Palë Kontraktuese zbulon që Pala tjetër Kontraktuese nuk mban dhe menaxhon në mënyrë efikase standardet e sigurisë në çdo zonë të tillë, të cilat të paktën të jenë të njëjta me standardet minimale të vendosura në atë kohë sipas Konventës së Çikagos, Pala e parë Kontraktuese njofton Palën tjetër Kontraktuese për këtë zbulim dhe për hapat që konsiderohen të nevojshme që ato të përputhen me standardet minimale dhe që Pala tjetër Kontraktuese të marrë masat e duhura. Mungesa e marrjes së masave të duhura nga Pala tjetër Kontraktuese, brenda 15 ditësh ose të një periudhe më të gjatë që mund të bihet dakord, do të jetë një arsye për zbatimin e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje (anulim ose pezullim i autorizimeve për veprim).

3.3 Pavarësisht nga detyrimi i përmendur në nenin 33 të Konventës së Çikagos, është rënë dakord që mjeti i fluturimit i drejtuar nga një ose disa linja ajrore, ose, nën një marrëveshje huadhënieje në emër të linjës apo linjave ajrore të një Pale Kontraktuese për shërbime për në dhe nga territori i Palës tjetër Kontraktuese, ndërsa është brenda territorit të Palës tjetër Kontraktuese, të mund t'i nënshtrohet një shqyrtimi nga përfaqësuesit e autorizuar të Palës tjetër Kontraktuese, në bord dhe përreth mjetit të fluturimit për të kontrolluar vlefshmërinë e dokumenteve të mjetit të fluturimit dhe të ekuipazhit të tij, si edhe gjendjen e mjetit të fluturimit dhe pajisjeve të tij (në këtë nen i quajtur "kontroll para fluturimit"), me kusht që kjo të mos çojë në vonesa të paarsyeshme.

3.4 Nëse një ose disa kontrole para fluturimit krijojnë:

a) shqetësime të mëdha që një mjet fluturimi ose komandimi i një mjeti fluturimi nuk plotëson standardet minimale të vendosura në atë kohë sipas Konventës së Çikagos, ose

b) shqetësime të mëdha që standardet e sigurisë të caktuara në atë kohë sipas Konventës së Çikagos nuk mirëmbahen dhe nuk menaxhohen me efikasitet,

Pala Kontraktuese që kryen një inspektim për qëllimet e nenit 33 të Konventës së Çikagos është e lirë të arrijë në përfundimin që kërkesat, sipas së cilës certifikata ose licenca në lidhje me atë mjet fluturimi ose në lidhje me ekuipazhin e atij mjeti fluturimi janë lëshuar ose janë bërë të vlefshme ose që kërkesat sipas të cilave mjeti i fluturimit komandohet nuk janë të njëjta ose janë mbi standardet minimale të caktuara sipas Konventës së Çikagos.

3.5 Në rast se përfaqësuesi i një apo disa linjave ajrore mohon hyrjen për të bërë një kontroll para fluturimit të një mjeti fluturimi të komanduar nga ose në emër të linjës ose linjave ajrore të një Pale Kontraktuese në përputhje me paragrafin 3.3, Pala tjetër Kontraktuese është e lirë të arrijë në përfundimin që shqetësimet e mëdha, si ato që përmenden në paragrafin 3.4, nxjerrin përfundimet e përmendura në atë paragraf.

3.6 Çdo Palë Kontraktuese rezervon të drejtën të pezullojë ose të ndryshojë menjëherë autorizimin për veprim të një ose disa linjave ajrore të Palës tjetër Kontraktuese, në rast se Pala e parë Kontraktuese arrin në përfundimin, qoftë si rezultat i një ose disa kontroleve para fluturimit, një mohimi për të bërë kontroll para fluturimit, konsultime ose tjetër, që masa e menjëhershme është thelbësore për sigurinë e funksionimit të një linje ajrore.

3.7 Çdo veprim i marrë nga një Palë Kontraktuese, në përputhje me paragrafët 3.2 ose 3.6 më lart, do të ndalohet sapo të përfundojnë së ekzistuarit arsyet për marrjen e tij.

Neni 8 **Sigurimi i aviacionit**

1. Palët Kontraktuese pohojnë përsëri që detyrimi i tyre për të mbrojtur, në marrëdhënien e tyre reciproke, sigurinë e aviacionit civil kundër akteve të paligjshme të ndërhyrjes përbën një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

Palët Kontraktuese, me anë të një kërkesë, sigurojnë të gjithë ndihmën e nevojshme për njëra-tjetrën për të parandaluar aktet e kapjes së paligjshme të mjeteve të fluturimit dhe akte të tjera të paligjshme kundër sigurisë së pasagjerëve, ekuipazhit, mjetit të fluturimit, aeroporteve dhe ambienteve të lundrimit ajror dhe çdo kërcënim tjetër për sigurinë e aviacionit.

Palët Kontraktuese veprojnë në përputhje me dispozitat e Konventës për shkeljet dhe disa akte të tjera të kryera në bordin e mjetit të fluturimit, të nënshkruar në Tokio më 14 shtator 1963, Konventën për ndalimin e kapjes së paligjshme të mjetit të fluturimit, nënshkruar në Hagë më 16 dhjetor 1970 dhe Konventa për shtypjen e akteve kundër sigurisë së aviacionit civil, nënshkruar në Montreal më 23 shtator 1971, si dhe çdo marrëveshje tjetër shumëpalëshe që rregullon sigurinë e aviacionit civil, e detyrueshme për Palët Kontraktuese.

2. Palët Kontraktuese, në marrëdhëniet e tyre reciproke, veprojnë në përputhje me dispozitat për sigurinë e aviacionit, të krijuara nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar dhe të hartuara si anekse të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar, në masën që këto dispozita sigurimi të jenë të zbatueshme për palët; ato kërkojnë që drejtuesit e mjetit të fluturimit të regjistrit të tyre ose drejtuese që kanë qendrën e tyre të biznesit ose banimin e përhershëm në territorin e tyre dhe drejtues të aeroporteve në territorin e tyre të veprojnë në përputhje me këto dispozita për sigurinë e aviacionit.

3. Çdo Palë Kontraktuese bie dakord të zbatojë dispozitat për sigurimin, të kërkuara nga Pala tjetër Kontraktuese për hyrjen në territorin e asaj Pale tjetër Kontraktuese dhe të marrë masat e duhura për të kontrolluar pasagjerët, ekuipazhin, objektet që mbajnë me vete, si dhe ngarkesën përpara hipjes ose zbritjes. Çdo Palë Kontraktuese e merr gjithashtu pozitivisht parasysht çdo kërkesë nga Pala tjetër Kontraktuese për masa të veçanta sigurie për mjetet e saj të fluturimit apo pasagjerët për t'u përballur me një kërcënim të veçantë.

4. Në rast të një incidenti ose kërcënimi për një incident të kapjes së paligjshme të mjetit të fluturimit ose akteve të tjera të paligjshme kundër sigurisë së pasagjerëve, ekuipazhit, mjetit të fluturimit, aeroporteve dhe ambienteve të lundrimit ajror, Palët Kontraktuese ndihmojnë njëra-tjetrën, duke lehtësuar komunikimin dhe duke marrë masa të tjera të duhura që synojnë përfundimin e shpejtë dhe të sigurt të këtij incidenti apo kërcënimi.

5. Nëse një Palë Kontraktuese shmanget nga dispozitat për sigurimin e aviacionit të këtij neni, autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese mund të kërkojnë konsultime të menjëhershme me autoritetet aeronautike të asaj Pale. Mosarritja e një marrëveshjeje të pranueshme brenda tridhjetë (30) ditësh përbën arsye për zbatimin e nenit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9 **Taksat mbi përdoruesin**

1. Taksat e vëna në territorin e një Pale Kontraktuese mbi linjën ajrore të caktuar të Palës tjetër Kontraktuese për përdorimin e aeroporteve dhe ambienteve të tjera të aviacionit nga mjeti i fluturimit i linjave ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese nuk duhet të jenë më të larta sesa taksat e vëna për një shërbim kombëtar të Palës së parë Kontraktuese të përfshirë në shërbime të ngjashme ndërkombëtare.

2. Çdo Palë Kontraktuese inkurajon konsultime ndërmjet autoriteteve të saj kompetente për vënien e taksave dhe linjave ajrore të caktuara që përdorin ambientet dhe shërbimet, kur janë të praktikueshme, me anë të organizatave përfaqësuese të linjave ajrore.

Njoftimi në kohë duhet të jepet për çdo propozim për ndryshime të taksës së përdoruesit, me qëllim që ata të shprehin mendimet e tyre përpara se të bëhen këto ndryshime.

Neni 10 **Doganat dhe akciza**

1. Çdo Palë Kontraktuese përjashton linjat ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese nga kufizimet e importit, detyrimet doganore, akciza, tarifat e inspektimit dhe detyrime të tjera kombëtare, rajonale apo lokale ose taksa për mjetin e fluturimit, karburantin, vajra lubrifikuese, pajisje teknike, pjesë këmbimi, përfshirë këtu motorë, pajisje të rregullta të mjeteve të fluturimit, pajisje tokësore, depo të mjeteve të fluturimit dhe artikuj të tjerë që synohen për përdorim ose që përdoren vetëm në lidhje me drejtimin ose ofrimin e shërbimit të mjetit të fluturimit të linjave ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese që drejton shërbimet e miratuara, si edhe bllokun e biletave të printuara, fatura të vijës ajrore, çdo material tjetër të printuar që ka simbolin e kompanisë së printuar në to dhe material i zakonshëm publiciteti i shpërndarë pa taksë nga ato linja ajrore të caktuara.

2. Përjashtimet e dhëna nga ky nen zbatohen për artikujt e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, qofshin këto artikuj të përdorur apo të konsumuar tërësisht brenda territorit të Palës Kontraktuese që jep përjashtimin, me kusht që këto artikujt:

a) të jenë prezantuar në territorin e një Pale Kontraktuese nga ose në emër të linjave ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese, por jo të tjetërsuara në Palën Kontraktuese në fjalë;

b) të jenë mbajtur në bordin e mjetit të fluturimit të linjave ajrore të caktuara të një Pale Kontraktuese me mbërritjen në apo largimin nga territori i Palës tjetër Kontraktuese;

c) të jenë marrë në bordin e mjetit të fluturimit të linjave ajrore të caktuara të një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe të synohen për përdorim në kryerjen e shërbimeve të miratuara.

3. Pajisja e fluturimit, pajisja tokësore, si dhe materiale e pajisje që mbahen zakonisht në bordin e mjetit të fluturimit të linjave ajrore të një Palë Kontraktuese, mund të zbarkohen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese vetëm me miratimin e autoriteteve doganore të atij territori. Në këtë rast, ato mund të vihen nën mbikëqyrjen e autoriteteve në fjalë deri kur të eksportohen përsëri ose në të kundërt të shiten në përputhje me legjislacionin doganor apo rregulloret në lidhje me to.

4. Bagazhi dhe ngarkesa në kalimin transit të drejtpërdrejtë përjashtohen nga detyrimet doganore dhe taksa të tjera.

5. Përjashtimet e parashikuara në këtë nen janë gjithashtu në dispozicion nëse linjat ajrore të caktuara të një Pale Kontraktuese kanë lidhur kontratë me një linjë tjetër ajrore që ka të drejtë në të njëjtën mënyrë për këto përjashtime nga Pala tjetër Kontraktuese për hua ose transferim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të artikujve të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

6. Asnjë dispozitë e këtij neni nuk e ndalon Mbretërinë e Belgjikës të vendosë taksa, detyrime, tarifa apo taksa të tjera për karburantin që sigurohet në territorin e saj për përdorim në një mjet fluturimi të linjës ajrore të caktuar të Republikës së Shqipërisë që operon ndërmjet një pike në territorin e Mbretërisë së Belgjikës dhe një pike tjetër në territorin e Mbretërisë së Belgjikës ose në territorin e një Shteti tjetër Anëtar.

Neni 11 **Kapaciteti**

1. Për linjat ajrore të caktuara të çdo Pale Kontraktuese ka mundësi të njëjta dhe të drejta për të kryer shërbimet e miratuara ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre përkatëse në rrugët e specifikuar në aneksin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Në kryerjen e shërbimeve të miratuara, linjat ajrore të caktuara të çdo Pale Kontraktuese marrin parasysh interesin e linjave ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese për të mos prekur së tepërmi shërbimet që Pala e fundit siguron gjatë gjithë rrugës së njëjtë ose një pjese të saj.

3. Shërbimet e miratuara të siguruara nga linjat ajrore të caktuara të Palëve Kontraktuese mbajnë marrëdhënie të duhura me kërkesat e publikut për transportimin në drejtimet e specifikuar dhe kanë si objektivin e tyre kryesor sipas një faktori të arsyeshëm ngarkese sigurimin e kapacitetit të duhur për të plotësuar kërkesat e mëparshme dhe të paraprirë në mënyrë logjike për transportin e pasagjerëve, ngarkesës dhe postës ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese.

4. Linjat e caktuara ajrore, jo më vonë se 30 ditë para datës së kryerjes së një shërbimi të miratuar, u dorëzojnë për miratim programet e tyre të propozuara të fluturimit autoriteteve të të dyja Palëve Kontraktuese. Programet e fluturimit në fjalë përfshijnë në mungesë llojin e shërbimit, mjetin e fluturimit që do të përdoret, frekuencat dhe oraret e fluturimeve.

Kjo zbatohet njësoj për ndryshimet e mëvonshme.

Në raste të veçanta ky afat kohor mund të ulet me miratimin e autoriteteve në fjalë.

Neni 12

Ndryshimi i kursit të drejtimit dhe ndarja e kodit

1. Linjat ajrore të caktuara të një Pale Kontraktuese mund të ndryshojnë kursin e drejtimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese sipas kushteve të mëposhtme:

a) zëvendësimi të justifikohet për arsye të ekonomisë së veprimit;

b) mjeti i fluturimit që vepron në sektorin më larg nga territori i Palës Kontraktuese që cakton linjat ajrore të veprojë vetëm në lidhje me mjetin e fluturimit në sektorin më të afërt dhe të planifikohet për këtë gjë; i pari arrin në pikën e ndryshimit për të mbajtur trafikun e transferuar nga ose për t'u transferuar në të dytën dhe kapaciteti vendoset duke pasur parasysh këtë qëllim;

c) linjat ajrore të mos e prezantojnë veten në publik me reklama ose tjetër formë, ndërsa sigurojnë një shërbim i cili e ka origjinën në pikën ku është bërë ndryshimi i mjetit të fluturimit, përveçse kur aneksi i kësaj Marrëveshjeje e lejon ndryshe;

d) në lidhje me çdo fluturim të mjetit të fluturimit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese ku është bërë ndryshimi, vetëm një fluturim mund të bëhet nga ai territor, përveçse kur është i autorizuar nga autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese për të drejtuar më shumë se një fluturime.

2. Pavarësisht nga klauzola e paragrafit 1 të këtij neni, në kryerjen e shërbimeve ajrore të miratuara në drejtimet e specifikuar në aneks, çdo linjë e caktuar ajrore mund të hyjë në rregullime për ndarjen e kodit me një linjë ajrore të çfarëdo kombësie, me kusht që linja ajrore e fundit të mbajë drejtimin e duhur dhe të drejtat e trafikut.

Neni 13

Tarifat

1. Palët Kontraktuese lejojnë që një tarifë në një nga drejtimet e specifikuar në aneks të vendoset nga secila prej linjave ajrore të caktuara.

2. Tarifat për vazhdimin e shërbimeve të miratuara për në dhe nga territori i Palës tjetër Kontraktuese vendosen në nivele të pranueshme, ndërsa merren parasysh të gjithë faktorët e duhur, përfshirë këtu koston e operimit, fitimin e arsyeshëm, karakteristikat e shërbimit dhe interesin e përdoruesve.

3. Tarifat u paraqiten autoriteteve aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese për miratim të paktën 45 ditë përpara datës së propozuar të prezantimit të tyre; në raste të veçanta, një periudhë më e shkurtër mund të pranohet nga autoritetet aeronautike.

Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e marrjes, autoritetet aeronautike të një Pale Kontraktuese nuk i kanë njoftuar autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, që nuk janë të kënaqur për tarifën që iu është paraqitur, kjo tarifë konsiderohet e pranuar dhe hyn në fuqi datën që tregohet në tarifat e propozuara.

Në rastin kur një periudhë më e shkurtër për paraqitjen e një tarife pranohet nga autoritetet aeronautike, ato gjithashtu mund të bien dakord që periudha për të dhënë njoftim pakënaqësie të jetë më pak se tridhjetë (30) ditë.

4. Nëse një njoftim pakënaqësie është dhënë në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese zhvillojnë konsultime në përputhje me nenin 17 të kësaj Marrëveshjeje dhe përpiqen të vendosin tarifën me marrëveshje ndërmjet tyre.

5. Nëse autoritetet aeronautike nuk mund të bien dakord për çdo tarifë që iu është paraqitur sipas paragrafit 3 të këtij neni ose për vendosjen e një tarife sipas paragrafit 4 të këtij neni, mosmarrëveshja zgjidhet në përputhje me dispozitat e nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje.

6. Nëse autoritetet aeronautike të një Pale Kontraktuese nuk kënaqen me një tarifë të caktuar, ato njoftojnë autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese.

Nëse brenda periudhës nëntëdhjetë (90) ditore nga data e marrjes së njoftimit të pakënaqësisë, nuk mund të vendoset një tarifë e re, zbatohen procedurat e parashtruara në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni.

7. Kur tarifat janë vënë në përputhje me dispozitat e këtij neni, këto tarifa qëndrojnë në fuqi derisa të vihen tarifa të reja në përputhje me dispozitat e këtij neni ose nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje.

8. Asnjë tarifë nuk hyn në fuqi nëse autoritetet aeronautike të njëjës Palë Kontraktuese nuk kënaqen me të, përveçse sipas dispozitës së paragrafit 4 të nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje.

9. Autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese përpiqen të sigurojnë që tarifat e vëna dhe të mbledhura të jenë në përputhje me tarifat e miratuara nga ata dhe të mos jenë subjekt i rabatit.

10. Tarifat që duhet të vihen nga linjat ajrore të caktuara të Republikës së Shqipërisë për transportin tërësisht brenda Komunitetit European i nënshtrohen së drejtës së Komunitetit European.

Neni 14

Kërkesat e stafit

1. Linjat e caktuara ajrore të një Pale Kontraktuese lejohen, në bazë të reciprocitetit, të mbajnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese përfaqësuesit e tyre dhe stafin tregtar drejtues dhe teknik të nevojshëm në lidhje me kryerjen e shërbimeve të miratuara.

2. Këto kërkesa për stafin, sipas mundësisë së linjave të caktuara ajrore, mund të plotësohen nga personeli i tyre i çfarëdo kombësie ose duke përdorur shërbimet e çdo organizate tjetër, kompanie apo linje ajrore që operon në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe të autorizohen për të kryer këto shërbime në territorin e asaj Pale Kontraktuese.

3. Përfaqësuesit dhe stafi u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të Palës tjetër Kontraktuese. Në përputhje me ligjet dhe rregulloret, çdo Palë Kontraktuese, në bazë të reciprocitetit dhe me vonesën minimale, u jep përfaqësuesve dhe stafit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lejet e nevojshme të punës, vizat e punësimit ose dokumente të tjera të ngjashme.

4. Për aq sa e lejon e drejta kombëtare, të dyja Palët Kontraktuese operojnë dhe pa kërkesat e lejeve të punës ose vizat e punësimit, ose dokumente të tjera të ngjashme për personelin që kryen disa shërbime ose detyra të përkohshme.

Neni 15

Shitjet dhe të ardhurat

1. Çdo linje ajrore të caktuar i jepet e drejta të përfshihet në shitjen e transportimit ajror në territorin e Palës tjetër Kontraktuese drejtpërsëdrejti dhe, me dëshirën e saj, me anë të agjentëve të saj.

Çdo linjë ajrore e caktuar ka të drejtë të shesë transportin në monedhën e atij territori ose, sipas dëshirës së saj, në valutë lehtësisht të këmbeshme të vendeve të tjera.

Çdo person do të jetë i lirë të blejë këto transporte në monedhën e pranuar për shitje nga ajo linjë ajrore.

2. Çdo Palë Kontraktuese i jep linjës ajrore të caktuar të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën e transferimit falas të të ardhurave nga shpenzimet e fituara nga linja e caktuar ajrore në territorin e saj. Këto transferita ndikohen nga kursi valutë zyrtar për pagesat aktuale ose, kur nuk ka kurse valutë zyrtare, nga kurset valutë të tregut të bursës për pagesat aktuale, të zbatueshme në ditën e paraqitjes së kërkesës për transferim nga linjat ajrore të caktuara nga Pala tjetër Kontraktuese dhe nuk i nënshtrohen detyrimeve të tjera përveç detyrimeve të mbledhura për shërbimet normale nga bankat për këto transaksione.

3. Çdo Palë Kontraktuese, në bazë të reciprocitetit, i përjashton linjat ajrore të caktuara të Palës tjetër Kontraktuese nga çdo lloj tatimi mbi të ardhurat apo përfitimet e nxjerra nga këto linja ajrore në territorin e Palës së parë Kontraktuese, të nxjerra përmes operimit të shërbimeve ndërkombëtare ajrore, si edhe nga çdo tatim mbi xhiron apo kapitalin.

Kjo dispozitë nuk zbatohet nëse një konventë për shmangien e tatimit të dyfishtë, që parashikon për një përjashtim të ngjashëm, është në fuqi ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 16

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet aeronautike të të dyja Palëve Kontraktuese shkëmbejnë informacion, sa më shpejt të jetë e mundur, në lidhje me autorizimet aktuale të zgjeruara të linjat e tyre ajrore të caktuara përkatësisht për të kryer shërbime në, përmes dhe nga territori i një Pale tjetër Kontraktuese. Kjo përfshin kopje të certifikatave aktuale dhe autorizimeve për shërbime në drejtimet e specifikuar, së bashku me ndryshimet, urdhrat e përjashtimit dhe modele të autorizuar të shërbimit.

2. Çdo Palë Kontraktuese bën që linjat e saj të caktuara ajrore të sigurojnë për autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese, po aq para kohe sa dhe në mënyrë praktike, kopje të tarifave, programeve, përfshirë këtu ndonjë modifikim të tyre dhe të gjithë informacionin tjetër përkatës në lidhje me kryerjen e shërbimeve të miratuara, si edhe informacionin për kapacitetin e siguar në secilën prej drejtimeve të specifikuar dhe çdo informacion të mëtejshëm që mund të jetë i nevojshëm për të bindur autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese që kërkesat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen si duhet.

3. Çdo Palë Kontraktuese bën që linjat e saj të caktuara ajrore të sigurojnë për autoritetet aeronautike të Palës tjetër Kontraktuese statistika në lidhje me trafikun e vazhduar me shërbimet e miratuara që tregojnë pikat e ngarkimit dhe të zbarkimit.

Neni 17

Konsultime

1. Autoritetet aeronautike të Palëve Kontraktuese konsultohen me njëra-tjetrën herë pas here, me synimin për të siguruar bashkëpunim të ngushtë në të gjitha çështjet që prekin zbatimin dhe respektimin e pranueshëm të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe anekseve të saj.

2. Këto konsultime fillojnë brenda një periudhe gjashtëdhjetë (60) ditore nga data e marrjes së një kërkesë të tillë, nëse Palët Kontraktuese nuk vendosin ndryshe.

Neni 18

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Nëse ndërmjet Palëve Kontraktuese lind një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët Kontraktuese, në radhë të parë përpiqen ta zgjidhin atë me anë të negociimit.

2. Nëse Palët Kontraktuese nuk arrijnë në një zgjidhje me anë të negocimit, ato mund të bien dakord t'ia çojnë mosmarrëveshjen për vendim një personi apo organi, ose njëra Palë Kontraktuese mund ta paraqesë mosmarrëveshjen për vendim nga tre gjyqtarë të një gjykate.

3. Gjykata e arbitrazhit përbëhet si vijon:

Secila Palë Kontraktuese cakton një arbitër brenda një periudhe gjashtëdhjetë (60) ditore nga data e marrjes, nga njëra Palë Kontraktuese, me rrugë diplomatike, të një kërkesë për arbitrazh nga Pala tjetër Kontraktuese. Këta dy arbitra, me marrëveshje, caktojnë një arbitër të tretë brenda një periudhe tjetër gjashtëdhjetë (60) ditore. Arbitri i tretë është shtetas i një shteti të tretë, vepron si kryetar i gjykatës dhe vendos vendin ku do të kryhet arbitrazhi. Nëse secila nga Palët Kontraktuese nuk arrin të caktojë një arbitër brenda periudhës së caktuar ose nëse arbitri i tretë nuk është emëruar brenda periudhës së caktuar, secila Palë Kontraktuese mund t'i kërkojë Presidentit të Këshillit të Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar të caktojë një ose disa arbitra sipas rastit.

4. Palët Kontraktuese marrin përsipër respektojnë çdo vendim ose vendim gjyqësor të marrë sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni.

Nëse njëra Palë Kontraktuese nuk arrin të respektojë këtë vendim, Pala tjetër Kontraktuese ka arsye të zbatojë nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje.

5. Shpenzimet e gjykatës së arbitrazhit ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 19

Modifikimet

1. Nëse njëra nga Palët Kontraktuese nuk e konsideron të nevojshme për të modifikuar një dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, ajo mund të kërkojë konsultime me Palën tjetër Kontraktuese. Konsultime të tilla, që mund të jenë ndërmjet autoriteteve aeronautike dhe që mund të bëhen me anë të diskutimeve apo korrespondencës, fillojnë brenda një periudhe gjashtëdhjetë (60) ditore nga data e kërkesës.

2. Nëse një konventë shumëpalëshe ajrore e përgjithshme hyn në fuqi në lidhje me të dyja Palët Kontraktuese, dispozitat e kësaj konvente kanë epërsi. Konsultimet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni mund të mbahen me synim për të caktuar se në çfarë mase dispozitat e konventës shumëpalëshe e prekin këtë Marrëveshje.

3. Çdo modifikim i rënë dakord në mbështetje të këtyre konsultimeve hyn në fuqi kur të jetë konfirmuar me një shkëmbim të notave diplomatike.

4. Palët Kontraktuese bien dakord që programi i rrugëve ajrore në aneks mund të modifikohet me marrëveshje midis autoriteteve diplomatike me anë të një rregullimi administrativ.

Neni 20

Përfundimi

1. Njëra Palë Kontraktuese, në çdo kohë, mund të njoftojë me shkrim, me rrugë diplomatike, Palën tjetër Kontraktuese për vendimin e saj për të përfunduar këtë Marrëveshje.

Një njoftim i tillë i komunikohet në të njëjtën kohë Organizatës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

2. Marrëveshja përfundon një (1) vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese, përveçse kur njoftimi për ta përfunduar atë tërhiqet me pëlqimin reciprok përpara përfundimit të kësaj periudhe.

Në mungesë të njoftimit për marrjen e tij nga Pala tjetër Kontraktuese, do të mendohet se njoftimi është marrë katërbëdhjetë (14) ditë pas marrjes së njoftimit nga Organizata e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

Neni 21
Regjistrimi

Kjo Marrëveshje dhe çdo ndryshim i saj regjistrohen në Organizatën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Secila Palë Kontraktuese njofton Palën tjetër Kontraktuese, me anë të rrugëve diplomatike, për përfundimin e formaliteteve kushtetuese të nevojshme që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas datës së njoftimit të fundit.

Me praninë e tyre, të plotfuqishmit e poshtëshënuar, të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, nënshkruan këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje origjinale në në ditën e në gjuhën angleze.

ANEKS
PLANI I ITINERARËVE

1. Itinerarët e Republikës së Shqipërisë

Pikat e nisjes	Pikat e ndërmjetme	Pikat në Belgjikë	Pikat përtej
Pikat në Shqipëri	Cilado	Pikat në Belgjikë	Cilado

2. Itinerarët e Mbretërisë së Belgjikës

Pikat e nisjes	Pikat e ndërmjetme	Pikat në Shqipëri	Pikat përtej
Pikat në Belgjikë	Cilado	Pikat në Shqipëri	Cilado

Çdo pikë ose pikat në itineraret e rëna dakord mund të përjashtohen nga linjat e përcaktuara ajrore të të dyja Palëve ose mund të operohen në një renditje tjetër për çdo ose të gjitha fluturimet, me kusht që pika e nisjes ose e mbërritjes të jetë në territorin e kombësisë së tyre.

LIGJ
Nr. 9684, datë 6.2.2007

**PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.9235, DATË 29.7.2004 “PËR
KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Zyra e AKKP-së në qendër ka këto përgjegjësi:

a) udhëheq dhe mbikëqyr punën për zbatimin e këtij ligji nga zyrat rajonale të qarqeve;
b) bën shqyrtimin fillestar të kërkesës për kompensim të subjektit të shpronësuar, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 11 të këtij ligji, për pasurinë e paluajtshme, të njohur për t'u kompensuar;

c) shqyrton ankimin ndaj vendimeve të zyrës rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionit vendor për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve;

ç) mund të shqyrtojë, me nismën e vet, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve.

Në zbatim të përgjegjësive të veta për kompensimin, zgjidhjen e ankimeve dhe shqyrtimin kryesisht të vendimeve të dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark apo ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së shprehet me vendim.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Vendimet e parashikuara në pikat 1 e 2 të këtij neni duhet të jenë në formë të shkruar, të arsyetuara, të nënshkruara nga titullari dhe të përbushin kërkesat për aktin administrativ, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Kur vendimi i parashikuar në pikat 1 e 2 të këtij neni nuk ankimohet ose nuk shqyrtohet nga Drejtori i AKKP-së brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, ai përbën titull ekzekutiv. Ngarkohen zyrat e përmbarimit për ekzekutimin e tij, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Tarifat për procedurat e kthimit dhe të kompensimit të pronave përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave.”.

Neni 2

Paragrafi i parë i pikës 1 të nenit 18 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të zyrës rajonale të AKKP-së në qark, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim, brenda 30 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, në zyrën e AKKP-së në qendër. Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish-komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim në zyrën e AKKP-së në qendër. Jo më vonë se 30 ditë nga regjistrimi i ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së merr vendim për objektin e ankimit.

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së ka të drejtë të shqyrtojë kryesisht, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, vendimet e dhëna nga zyrat rajonale të AKKP-së në qark. Drejtori i Përgjithshëm shqyrton edhe vendimet e dhëna nga ish-komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, si dhe ish-komisionet e rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve. Pas shqyrtimit kryesisht ose shqyrtimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së vendos:

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të tij;
- c) kthimin për rishqyrtim në zyrën rajonale të AKKP-së.”.

Neni 3

Pas nenit 28/2 shtohet neni 28/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 28/3

Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, për vendimet e ish-komisioneve vendore të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe ish-komisioneve të rretheve ose bashkive për kthimin ose kompensimin e pronave ish-pronarëve, të ankimuara dhe të depozituara në Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, para krijimit të AKKP-së, të mbetura pa shqyrtuar, shprehet me vendim brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5203, datë 8.2.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**VENDIM
Nr. 69, datë 6.2.2007**

**PËR ZGJEDHJEN E DY ANËTARËVE TË KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 154 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 22 pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

- I. Zoti Shkëlqim Hysi zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- II. Zoti Genti Shala zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

DEKRET
Nr. 5202, datë 7.2.2007

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

- | | |
|---|--------------------------------|
| 1. Ramiz Muhamet Lladrovci | 9. Valbone Muhamet Lladrovci |
| 2. Lapidar Ramiz Lladrovci | 10. Emri Muhamet Lladrovci |
| 3. Kosovare Ramiz Lladrovci | 11. Sylejman Shaban Selimi |
| 4. Drilon Ramiz Lladrovci | 12. Donika Sylejman Selimi |
| 5. Rilind Ramiz Lladrovci | 13. Etnik Sylejman Selimi |
| 6. Shemsije Rrahman Istogu-Lladrovci (Istogu) | 14. Rion Sylejman Selimi |
| 7. Muhamet Mehmet Lladrovci | 15. Kimete Vehbi Selimi (Geci) |
| 8. Shefkie Halim Lladrovci (Nika) | 16. Veton Rexhai Surroi |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 1. **PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 2. **PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 3. **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 4. **PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

BOTIME TË REJA

1. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
2. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
3. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
4. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
5. **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
6. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
7. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
8. **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
9. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 12.2.2007
 Doli nga shtypi më 14.2.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Grafon"
 Tiranë, 2007

Çmimi: 28 lekë